

FIP
FEDERATA NDËRKOMBËTARE E FILATELISË
Themeluar më 1926
KOMISIONI PËR MAKSIMAFILINË
UDHEZIME PËR GJYKIMIN E EKSPONATEVE TË MAKSIMAFILISË

1. Ekspozita konkurruese

Këto udhëzime plotësojnë Rregullat e përgjithshme(GREV) dhe Rregullat e veçanta (SREV) që ndihmojnë jurinë në vlerësim dhe ekspozuesit në hartimin dhe përpunimin e eksponeve të maksimafilisë.

2. Ekspонатet konkurruese

2.1 Një ekspонат maksimafilie përbëhet krejtësisht nga karta maksimum.

2.2 Cilësia e elementeve përbërës dhe përputhja e këtyre elementëve i japin kartës maksimum kualifikimin e “materialit të duhur filatelik “(GREV Neni 3.1)

3. Parimet e hartimit të një eksponati.

Elementet përbërës duhet të jenë konform kushteve të mëposhtëme që plotësojnë Nenin 3 të SREV.

3.1 Pulla postare

- Ajo duhet të jetë në gjëndje shumë të mirë.
- Vetëm një pullë postare duhet të ngjitet nga ana e pamjes së kartolinës. Para vitit 1978 kur u aprovua “Statuti Ndërkombëtar i Maksimafilise “, toleroheshin kartat maksimum me disa pulla postare, nëse njëra (apo disa prej tyre) kishte përputhje me pamjen mbi kartolinë.
- Në rast se një pullë postare ka subjekte të shumëfishta, sekondare apo pjesore, çdo subjekt sa më shumë që të jetë e mundur duhet të ketë përputhjen e tij.
- Pulla postare (apo një bllok pullash(souvenir sheet) i cili i përket kësaj pulle në qoftë se është ngjitur mbi kartolinë) nuk duhet të mbulojë më tepër se çerekun e kartolinës.
- Kur e njëjta temë është shpërndarë në disa pulla të ngjitura(se-tenant) që formojnë një panoramë, atëherë seria mund të vendoset në një kartolinë të vetme. Megjithatë kur subjekti është i izoluar në një nga pullat se-tenant, në kartolinë duhet të vendoset vetëm ajo pullë në të cilën subjekti i trajtuar ilustron me kartolinën.
- Lejohet përdorimi i një shtypje të ilustruar postare, e parapaguar, e realizuar nga shpërndarës automatik e cila është fiksuar nga pamja e kartolinës.
- Në përgjithësi temat abstrakte apo simbolike nuk i shkojnë për shtat maksimafilisë dhe janë të përjashtuara nga fusha e saj.
- Për një temë të veçantë rendi i preferencave është:

Pulla postare e emetuar sipas programit filatelik të operatorit postar të përcaktuar(Autoriteti postar), ku ajo është si temë kryesore ose temë sekondare lehtësisht e identifikueshme, pastaj pulla postare e personalizuar dhe së fundi pulla e një operatori të autorizuar(autoritet postar).

3.2 Kartolina (me pamje;pikturë)

- Kartolina duhet të ketë qënë në shitje sa më larg që të jetë e mundur përpara emetimit të pullës postare ose në qoftë se ajo ka qënë botuar si rast i veçantë atëherë ajo duhet të riprodhojë një dokument që ka ekzistuar më parë.
 - Lejohen vetëm formatet katror dhe drejtkëndësh.Të gjitha të tjerat janë përjashtuar.
 - Objektet e mëposhtëme nuk duhet të përdoren për kartat maksimum:
- Piktura(pamje) të kombinuara, të prera, fotografi private në leter fotografike, fotokopje me ngjyra apo bardhë e zi, fotomontazhe, vizatime, dokumenta të hartuara posaçërisht për emetimin e pullës të cilat shtypen privatisht në letër fotografike në saj të kompjuterit.

3.3 Vula(njolla e vulës)

- Vulosja që tregon emrin dhe datën e zyrës postare duhet të jetë legjitime. Ajo duhet të jetë e plotë dhe të lidhë pullën postare me kartolinën.Kjo vlen si për vulosjet me dore ashtu dhe me makinë.

- Vulosjet e pailustruara pranohen me kusht që ato të tregojnë emrin e vendit ku ndodhet zyra postare duke respektuar përputhjen me vendin.

3.4 Klasifikimi i koleksioneve

a) Koleksionet sipas një vendi apo grupi vendesh përfshijnë kartat maksimum të krijuara me pulla të emetuara nga një vend apo grup vendesh që kanë lidhje gjeografike, historike apo kulturore. Në përgjithësi duhet të mënjanohet renditja kronologjike e emetimeve, përveç ekspozateve tradicionale të kufizuara në një periudhë të caktuar.

b) Koleksionet e specializuara dhe /apo studimore bazohen, sipas zgjedhjes së ekspozuesit, ose në elementët përbërës të kartës maksimum, ose në përputhjet e ndryshme ose në të dyja, ose në një periudhë të veçantë.

c) Koleksionet tematike përfshijnë kartat maksimum të lidhura me një temë. Ato nuk janë të kufizuara as në kohë dhe as në hapësirë.

Në këto tre tipe koleksionesh, të ashtuquajturat "Variante të kartave maksimum" d.m.th. karta maksimum me të njëjtën pullë të ngjitur në kartolina të ndryshme me vulosje të ndryshme, mund të ekspozohen njëkohësisht por gjithmonë duke pasur parasysh rregullat e përputhjes. N.q.se koleksioni nuk ka të bëjë vetëm me variante të kartave maksimum, atëherë numri i tyre duhet të jetë i kufizuar me qëllim që të mos tregojë një zhbalancim apo mungesë materiali në ekspozat. Maksimumi në një kornizë ekspozimi duhet të ketë dy variante kartash maksimum. Një datë tjetër në vulosjen e së njëjtës pullë nuk mjafton për të bërë një variant të kartës maksimum.

3.5 Plani

Koleksioni duhet paraprirë nga një plan i hartuar në një faqe të vetme. Ai duhet të përshkruajë përmbajtjen e koleksionit dhe të tregojë qartë idenë kryesore. Duhet të jetë llogjik, i balancuar mirë në përputhje me temën dhe titullin e zgjedhur. Ai duhet të jetë i ndarë në kapituj. Një tabelë përmbajtje e tjeshtë (skematike) ose një përshkrim fjalë për fjalë nuk mund të konsiderohet si një plan i kënaqshëm. Ai duhet të jetë shkruar në njërën nga gjuhët zyrtare të FIP-it.

4. Kriteret për vlerësimin e ekspozateve

4.1 Ekspozatat e kartave maksimum gjykohen sipas Nenit 4 të GREV (Rregullat e përgjithshme të FIP-it për vlerësimin e ekspozateve konkurruese në ekspozitat e FIP-it) dhe sipas SREV (Rregullat e veçanta të FIP-it për vlerësimin e ekspozateve të kartave maksimum në ekspozitat e FIP-it).

4.2. Trajtimi dhe rëndësia e ekspozatit.

Gjithsej 30 pikë, 20 për trajtimin dhe 10 për rëndësinë.

Trajtimi dhe zhvillimi i një ekspozati ka të bëjë me çështjet e mëposhtme:

- Një kordinim i mirë ndërmjet titullit, planit dhe përmbajtjes së ekspozatit
- Një klasifikim llogjik dhe i menduar i kartave maksimum përshtatur mirë me idenë kryesore të planit.

- Shpjegimet e shkruara duhet të jenë konçize (të shkurtëra që japin informacion me pak fjalë) dhe të japin një informacion shtesë mbi elementët dhe / ose përputhjet.

Rëndësia e ekspozatit lidhet me vështirësinë e zhvillimit të temës së zgjedhur sipas materialit të njohur dhe ngushtësisë së temës së trajtuar.

4.3 Njohuria dhe Kërkimi

Gjithsej 35 pikë, 20 për Njohurinë dhe 15 për Kërkimin.

Ekspozuesi gjykohet nga mënyra se si i ka zgjedhur kartat maksimum të koleksionit të tij/të saj; ekspozati i tij/i saj duhet të demonstrojë qartë njohuritë mbi temën e zgjedhur, mbi pullën postare, vulat postare si dhe për pikturën e kartolinës kur të jetë e nevojshme.

- **Njohuria mbi pullën postare** gjykohet sipas interesit që ka treguar në komente (Qëllimi dhe data e emetimit , figura , shtypja , variacioni , data e fundit e vlefshmërisë ...)

- **Njohuria mbi vulat postare** (postal markings) mbulon tipet e vulosjes (types of cancellation), periudhën e përdorimit dhe justifikimin e përdorimit të kësaj vulosje (vendi, ilustrimi, teksti, ...). Të gjitha përpjekjet për të përmiresuar njollën e vulës pasi autoritetet postare e kanë realizuar atë do të konsiderohen si falsifikim.

• **Njohuria mbi kartolinën** gjykohet sipas përputhjes së saj me subjektin e pullës postare, cilësisë dhe rrallësinë e botimit.

Kërkimi në maksimum bazohet në respektimin e përputhjes së të trijave: subjekti, vendi, koha.

♠ **Përkimi (përputhja) e subjektit** është karakteristikë themelore e një karte maksimum të vertetë. Përkimi ndërmjet ilustrimit të pullës postare dhe asaj të kartolinës duhet të jetë sa më i ngushtë që të jetë e mundur dhe shikimisht i verifikueshëm,

♠ **Përkimi i vendit** kërkon një lidhje ndërmjet emrit të vendit apo lokalitetit të shkruar në vulë dhe subjektit të pullës postare si dhe të kartolinës. Vulosja e ditës së parë mund të përdoret kur ajo është në pajtim me kushtin e përmendur më sipër.

• Për monumentet, peisazhet, vendet e ngjarjes ka vetëm një vend që jep përkimin e duhur. Ai është vendi ku monumenti, peisazhi apo ngjarja është vendosur. Në qoftë se vendi nuk ka zyrë postare, duhet zgjedhur ajo zyrë që shërben në atë zonë ose ajo që është më afër vendit në fjalë.

• Kur subjekti është një personalitet, vulosja duhet bërë në një vend që ka lidhje me ngjarjen që i përket atij/asaj: Lindja, vdekja, varrosja, puna ose aspekt nga aktiviteti i tij/saj, nderimi pas vdekjes etj. Kur pulla postare përkujton në mënyrë të qartë një nga këto ngjarje, vulosja e vendit ku ka ndodhur është më e mira.

• Në rast se pulla postare përkujton një ngjarje vulosja duhet bërë në vendin që lidhet me të.

• Kur pulla postare tregon p.sh. një aeroplan, tren apo anije, vulosja duhet bërë në një vend ku ka aeroport, stacion hekurudhor, port ose zyrë postare në lëvizje që lidhet me subjektin.

• Kartat maksimum që tregojnë aktivitete sportive janë më të mira në qoftë se janë vulosur në vendet ku praktikohen këto sporte.

• Kartat maksimum që tregojnë vepra arti të tilla si: piktura, skulptura, mozaikë, piktura në zmall, dritare xhami të armuara (leaded glass windows), afreske, sixhade muri dhe në përgjithësi të gjitha objektet në muzeume apo koleksione, duhet të vulosen ose në vendin ku janë gjetur ose në vendin ku janë krijuar. Vulosjet në vende të tjera lejohen në ekspozita lokale dhe ngjarje të tjera në qoftë se ato janë në përputhje me punën (nënshkrimi apo portreti i artistit, portreti i modelit etj.) Megjithatë në gjykimin e eksponateve mbi “veprat e artit” duke marrë parasysh natyrën e tyre universale, juria duhet të lejojë vulosjen e vendit emetues të pullës. Sidoqoftë në rastin kur e njëjta vepër arti tregohet në pullat postare të vendeve të ndryshme, karta maksimum me pullën dhe vulosjen e vendit ku është gjetur kjo vepër arti do të konsiderohet më e mirë.

Kur një vepër arti është pjesë integrale e një monumenti (skulpturë, afresku, dritare xhami të armuar, mozaiku, etj.) vulosja e preferuar është ajo e zyrës postare më të afërt me vendin ku monumenti është vendosur.

• Në rastin e pullave postare që tregojnë subjekte të vendosura në një vend të ndryshëm nga ai i emetimit, përjashtimi i përmendur më sipër zbatohet për personalitetet dhe temat e lidhura me kozmosin. Vulosja duhet të jetë nga një lokalitet i vendit që ka emetuar pullën ku ka qenë organizuar ngjarja që lidhet me qëllimin e emetimit.

• Kur pulla postare përkujton një ngjarje ose tregon një peisazh apo një monument të një vendi tjetër atëherë realizimi i kartës maksimum është i pamundur meqenëse mungon plotësisht përputhja e vendit.

• Lejohen vulosjet e realizuara jashtë vendit nga zyrat postare të atij vendi (në rast të një ekspozite filatelike apo raste të tjera).

• Vulosja është akoma më interesante kur bëhet në një vend, i lidhur ngushtësisht me subjektin e cila plotëson në mënyrë harmonike çiftin pullë postare- kartolinë prej ilustrimit apo tekstit të saj dhe ajo të ketë qenë përdorur për një kohë pak a shumë të shkurtër.

♠ **Përputhja e kohës** përcaktohet nga data e vulës, brenda periudhës së vlefshmërisë së pullës.

4.4 Gjendja dhe rrallësia e materialit

Gjithsej 30 pike, 20 për rrallësinë dhe 10 për gjendjen e objekteve të treguara.

Rrallësia e kartës maksimum varet nga:

• rrallësia relative e të tre elementëve secili për hesap të vet.

• Vështirësia e realizimit dhe/ose vjetërsia e saj.

Vjetërsia përcaktohet duke iu referuar tre periudhave:

A. Para 1946, data që shënon publikimin e parë të përcaktimit të kartës maksimum

B. Nga viti 1946 deri në vitin 1978

C. Pas vitit 1978, data e miratimit nga FIP-i i “Rregullave të Kartës maksimum”

4.5 Paraqitja

5 pikë mund të jepen për paraqitjen

- Paraqitja duhet të jetë e mirë deri në fund dhe të japë një përshtypje të përgjithshme gjithashtu të mirë. Prandaj ekspozuesit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
- Të përdorin fletë format me ngjyrë të çelur.
- Të paraqesin materialin e zgjedhur në mënyrë harmonike, maksimumi 2 karta maksimum për fletë format duke mënjeluar fletët me boshllëqe apo të mbingarkuara dhe objekte të mbivendosura.
- Teksti shoqërues të jetë konçiz, i lexueshëm dhe pa gabime.

5. Gjykimi i eksponeve

Për të bërë një gjykim të llogjikshëm, juristët e ekspozatit të maksimafilisë duhet të plotësojnë fletën e vlerësimit dhe të bëjnë disa vërejtje për ekspozuesin si dhe t’i japin ndonjë keshillë për përmirësimin e ekspozatit.

Meqënëse falsifikimet nuk pranohen, ekspozuesit këshillohen që objektet e dyshimta t’i kenë të certifikuara.

6. Kushtet e zbatimit

Këto” Udhëzime për gjykimin e eksponeve të maksimafilisë” janë pranuar unanimisht nga Komisioni i Maksimafilisë së FIP-it në Konferencën e zhvilluar në Xhakarta më 22 qershor 2012 pasuar me qartësimin e paragrafit 3.1 me terminologji të thjeshtë dhe të qartë, pranuar nga anëtarët e Byrosë së Komisionit të Filatelistë së FIP-it më 9 nëntor 2013 dhe aprovuar nga bordi i FIP-it në Rio de Janeiro më 23 nëntor 2013. Ato u aprovuan gjithashtu nga Kongresi i 73^{të} i FIP-it në Seul, Kore e Jugut më 12 Gusht 2014.

Përkthyer nga **Edmond Budo**

Tiranë, më 11.08.2010 ; përditësuar në shtator 2015.